Siguria financiare në internet

6 Këshilla

Sigurohuni që blerjet tuaja në internet të jenë nga faqe zyrtare dhe të sigurta

1

Kontrolloni që faqja të ketë një adresë që fillon me https dhe kini kujdes për gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore.
Shikoni faqet 'Rreth nesh' dhe/ose 'Na kontaktoni' për t'u siguruar që ka të dhëna kontakti legjitime.

Asnjëherë mos bëni blerje me kartë krediti përmes Wi-Fi publik

2

Kur përdorni një lidhje publike Wi-Fi, nuk keni kontroll të drejtpërdrejtë mbi sigurinë e saj.
Lidhuni me një rrjet të sigurt përpara se të jepni informacione, si numri i llogarisë tuaj bankare.
Gjithashtu, mund të përdorni një VPN ose fikni Wi-Fi dhe të përdorni *mobile data* të pajisjes suaj.



Zgjidhni fjalëkalime komplekse

3

Zgjedhja e fjalëkalimeve që janë të lehta për t'u mbajtur mend i bën ato të lehta për t'i hamendësuar hakerat.
Sigurohuni që fjalëkalimet tuaja të jenë të forta dhe mos përdorni të njëjtin fjalëkalim për llogari të ndryshme.

Bëhuni dyshues për mesazhe urgjente, emaile ose telefonata që supozohet se janë nga banka juaj ose institucione të tjerë

4

Nëse një email është i papritur, është shënuar si urgjent dhe/ose kërkon veprim të menjëhershëm, ndoshta është i rremë.
Mashtruesit përdorin gjuhë urgjente për për t'i detyruar përdoruesit të ndajnë informacionet e tyre personale.
Mos reagoni! Merrni kohën tuaj dhe komunikoni drejtpërdrejt me bankën/institucionin për vërtetësinë e mesazhit/telefonatës/emailit.

Bëhuni dyshues për çdo tekst ose email që ju thotë se keni për të marrë para

5

Një tekst ose email që premton një fitim të papritur do të tërheqë gjithmonë vëmendjen tonë.
Mesazhe të tilla janë zakonisht mashtrime, sidomos nëse ju kërkon të dërgoni para ose informacion personal si garanci përpara tërheqjes së shumës së premtuar!

Kujdes nga mashtrimet në rrjetet sociale

6

Kriminelët kibernetikë përdorin një sërë mashtrimesh në mediat sociale për t'u përpjekur të aksesojnë informacionin tuaj personal ose paratë tuaja!
Ata mund të qëndrojnë pas kërkesave për miqësi dhe kuizeve të ndryshme.
Gjithashtu, nëse ju vijnë links të dyshimtë, mos klikoni mbi ta! Klikimi mund t'ju çojë në faqe interneti *phishing*.

#ThinkCyber

#ThinkB4UClick